



## Këshilla për prindër:

Disa aktivitete që mund të ndërmerrni për të ndihmuar fëmijët tuaj:

- \* Përfshini fëmijët tuaj në marrjen e vendimeve për blerjen e gjësendeve të vogla;
- \* Kryeni blerjet bashkë me fëmijët tuaj dhe gjatë blerjes të krahasoni çmimet;
- \* Përdorni kartelat e zbritjes dhe diskutoni me fëmijën tuaj sa para keni kursyer;
- \* Mësoni fëmijëve dallimin mes nevojave, kërkesave dhe dëshirave;
- \* Mësoni të respektojnë vlerën e parasë;

- \* Shfrytëzo rastin që çdo ditë t'iu jepni mësim të shkurtra për paratë. Në këtë mënyrë ju do t'iu krijoni qasjen dhe sjelljen e duhur ndaj parasë;
- \* Inkurajoni fëmijët tuaj duke i shpërblyer kur ata janë të sjellshëm ose angazhoni rreth punëve të shtëpisë (p.sh, duke i mbledhur lodrat e tyre, duke e rregulluar dhomën e tij/saj etj);
- \* Ndihmohuni të bëjnë një listë të gjërave që ata mund të punojnë (të jetë e përshtatshme për moshën e tyre);
- \* Mësoni fëmijëve tuaj si të kursehet, të shpenzohet dhe të dhurohet.

Departamenti për Marrëdhënie me Jashtë  
Banka Qendrore e Republikës së Kosovës  
Garibaldi 33, 10000 Prishtinë  
Tel: +381 (0) 38 222 055  
Fax: +381 (0) 38 246 879  
info@bqk-kos.org  
www.bqk-kos.org



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVO  
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

## Mbill sot, që të korrësh nesër!



MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË  
MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE, NAUKU I TEHNOLOGIJU  
MINISTRY OF EDUCATION, SCIENCE AND TECHNOLOGY



SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS  
KOSOVO BANKING ASSOCIATION

## Çka janë kursimet?

Kursime janë paratë që ne nuk i shpenzojmë sot, i ruajmë ato për më vonë, për t'i shpenzuar për gjëra që na nevojiten në të ardhmen.

Ne të gjithë kemi dëshira të ndryshme por duhet të mësojmë të shpenzojmë paratë në mënyrën e duhur dhe të mos i shpenzojmë pa ndonjë arsye.



## Arsyet pse kursejmë janë:

- \* Për të bërë një udhëtim;
- \* Për të blerë gjësendet që na mundësojnë t'i praktikojmë dëshirat tona (video lojë, instrument muzikor, biçikletë, aparat fotografik);
- \* Për një të ardhme të sigurt (për të investuar në shkollim);
- \* Për raste emergjente;
- \* Për të blerë dhuratat;
- \* Për të ndihmuar njerëzit në nevojë.

## Si të kursejmë?

- \* Duke shpenzuar më pak nga të hollat që prindërit i japin;
- \* Duke marrë ushqimin nga shtëpia për ta ngrënë më vonë në pushimin e gjatë të shkollës dhe në këtë mënyrë ju do të kurseni ca nga të hollat;
- \* Duke ju ndihmuar prindërve rreth punëve të shtëpisë dhe duke i gëzuar ata me suksesin tuaj në shkollë, ata mund t'iu shpërblejnë.

## Cili është plani i duhur për mua?

Hapat që duhet ndjekur janë:

- \* Mendoni për çka po kurseni. Cili është qëllimi juaj;
- \* Bëni llogari sa para do t'iu duhet të vendosni në arkën tuaj të kursimeve;
- \* Filloni sot të kurseni dhe llogaritni pas sa kohe ju do të keni grumbulluar paratë e nevojshme.

## Tregime lidhur me kursimet

**(ARTANI):** Nëna dhe babai më dhanë një shumë të hollash prej 12 Eurosh në çdo fundjavë për ndihmën që ju ofrova atyre rreth punëve të shtëpisë. Tani që kanë kaluar 5 javë unë kam grumbulluar 10 euro. Unë i pranova, u falënderova dhe pastaj dola në qendrën tregtare dhe bleva gjësende për të ngrënë dhe luajtur. Por tani si t'ia bëj? Më pëlqeu shumë një libër enciklopedik për të gjitha kafshët e botës dhe unë tani i kam shpenzuar të gjitha paratë. Do të duhet shumë kohë që unë prapë të kem atë

shumë parash në duart e mia. Ndoshta derisa unë të bëj prapë para, libri im i preferuar enciklopedik do të shitet.



**(ARIANA):** Nesër, shoqja ime Vesa ka ditëlindjen dhe unë nuk kam të holla që t'i blej një dhuratë të mirë. Kam shumë pak para të cilat nuk më mjaftojnë për t'i blerë Vesës kapelën që i pëlqente shumë. Përveç kësaj, vëllai im sapo u regjistrua në fakultet dhe tani nuk ka para për të paguar studimet. Pa bërë pagesën ai nuk mund të shkollohet. Tani ai duhet të gjejë punë dhe të kursejë që vitin tjetër të fillojë studimet prapë. Duke e parë atë, unë duke filluar që sot do të kursej në mënyrë që të shkollohem në të ardhmen aty ku dua unë.